



Zëri i Grave Kosovare

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në Kosovë

Bashkangjituni!

Dhuroni gjak në Ditën Ndërkombëtare të Gruas! 8 Mars 2013, 12:00 sheshi Nëna Terezë, Prishtinë

Dorëzoni aplikacionet në Fondin e Grave të Kosovës, Afati: 15 Mars 2013

Mbledhja e Rregullt e radhës e RrGGK-së: 8 Prill 2013, 11:00, Hotel Prishtina

Në këtë botim

Dragash Krijon Mekanizmin kundër Dhunës në Familje.....2

Grantet e Fondit të Grave të Kosovës të gatshme....2

RrGGK Zgjedh Kryetaren e Re të Bordit.....3

Anëtarët takohen për Mbledhjen e Rregullt...3

Kosova u Bashkua në One Billion Rising



Më 14 Shkurt, Kosova iu bashkua 207 vendeve, duke shënuar V-Day (V-Dita) në aksionin më të madh global në histori për të ndaluar dhunën ndaj grave dhe vajzave. Për të shënuar përvjetorin e vet të 15-të, V-Day lansoi fushatën e saj më ambicioze deri më sot, *One Billion Rising (Një Miliardë Ngrihen në Këmbë)*. “One Billion” rrjedh nga statistika që një në tre femra përjetojnë dhunën gjatë jetës së tyre, dhe kështu më shumë se një miliardë femra nëpër botë janë të prekura nga dhuna. Fushata mbarë botërore e V-Day për vitin 2013, inkurajoi një miliardë femra dhe njerëz që i duan ato që të “Ecin, Vallëzojnë, të Ngriten në këmbë dhe të Kërkojnë” t’i ipet fund dhunës.

“Është një ndër fushatat më atraktive që kam parë deri më tani,” tha Fitorja, pjesëmarrëse në ngjarjen e Kosovës për One Billion Rising “dhe mendoj që ka pasur një ndikim të madh.”

Vullnetarë të moshave 15-17 organizuan ngjarjen e Kosovës. Grupi organizatorë përfshinte anëtarë të grupit medial Kosovo 2.0 dhe të Rrjetit të Grupeve të Grave të Kosovës (RrGGK). Ata krijuan një faqe të Facebook-ut *One Billion Rising Kosovo*, dhe *Kosovo 2.0* bëri mbulimin medial. Albulena Shabani një artiste shqipëtare nga Maqedonia krijoi një *video promocionale*. Dy të rinjë organizatorë, Lindi dhe Andrea, performuan një emetim të këngës së Rita Ora-s “Shina Ya Light” me një thirrje speciale të One Billion Rising. One Billion Rising në Kosovë mbledhi gra dhe burra për të Ecur, Vallëzuar dhe për tu Ngritur në këmbë në një ndejë në ambient të hapur në rrugë, mbi platonë e Pallatit të Rinisë në Prishtinë, nën muzikën e lëshuar nga Oda Haliti. Të rinjë e të vjetër iu bashkangjitën ndejës, duke demonstruar rezistencën e tyre kundër dhunës ndaj femrës.

“Pse nuk kemi më shpesh ndeja të tilla?” u ankua një vajzë 10 vjeçare. “Vallëzimi në rrugë është një mënyrë e shkëlqyer për të ngritur zërat tanë për çështje të tilla të mëdha,” u pajtuan pjesëmarrës të tjerë.

V-Day e mbajtur në Ditën e Shën Valentinit, është një lëvizje globale aktiviste që synon t’i jap fund dhunës kundër grave dhe vajzave. Ajo përfshinë ngjarje të ndryshme që synojnë ngritjen e vetëdijes, sigurimin e fondeve dhe mbështetjen e punës së organizatave që punojnë kundër dhunës. Përmes fushatave të V-Day, vullnetarë dhe studentë kanë krijuar shfaqje si ajo Monologjet e Vaginës dhe dokumentarë të tjerë.



Të rinjët e Kosovës marrin pjesë në fushatën globale One Billion Rising për të ndaluar dhunën kundër grave dhe vajzave.

 **Faqen Facebook Grupin Facebook**

 **Listës së dërgesave për e-Lajme**

Dragash Krijon Mekanizmin kundër Dhunës në Familje

Përfaqësuesit e shoqërisë civile, zyrtari lokal për barazi gjinore dhe policia në Komunën e Dragashit e dinin që kishin nevojë për një mekanizëm për raportimin e dhunës në familje. Dhuna në familje ekziston në komunën e tyre, por njerëzit hezitojnë ta denoncojnë atë. Për shkak të pozitës së lartë e malore të Dragashit, largë prej mundësive për edukim të lartë, gratë atje kanë tendencë të kenë shkallë më të ulët të arsimimit. Kjo limiton lirinë e tyre ekonomike dhe atë sociale. Ato ndihen të “kontrolluara dhe menaxhuara” nga rregullat e pa shkruara shoqërore që mbizotrojnë atje, tha aktivistja e të drejtave të grave Gjejrane Lokaj nga Shoqata Iniciativa e Grave, një organizatë anëtare e RrGGK. Ajo dhe përfaqësues të tjerë të shoqërisë civile, zyrtari për barazi gjinore dhe policia vendosën t'i ngrisin këto çështje nën vëmendjen e institucioneve vendore dhe ndërkombëtare.

Ata gjetën mbështetje nga agjencitë e UN-it (KB-së), që pilotuan një projekt mbi dhunën në baza gjinore në Dragash. Koordinatorja Komunale kundër Dhunës në Familje e mbështetur nga UNDP-ja, organizoi mbledhje të rregullta në mes të organizatave të shoqërisë civile, organizatave ndërkombëtare, policisë, institucioneve gjyqësore, drejtorë të drejtorive të ndryshme komunale, institucioneve vendim-marrëse dhe akterë të tjerë që mirren me këtë çështje. Këto takime rezultuan me krijimin e Mekanizmit kundër Dhunës në Familje, duke përfshirë akterët e lartpërmendur. Mekanizmi ka përzgjedhur udhëheqësinë e vet dhe është në rrugë e sipër të krijimit të dokumenteve zyrtare të tij që do ta zyrtarizonin mekanizmin dhe do t'i mundësonin atij të punojë në baza ligjore.

Viktimat potenciale të dhunës në familje mund të kontaktojnë anëtarët e mekanizmit. “Emrat tanë janë publik dhe ne jemi afër qytetarëve, me qëllim që ta bëjmë më të lehtë raportimin e dhunës,” tha Gjeranja, si njëra ndër themelueset e mekanizmit. “Njëra ndër motot tona është: nuk është turp të jeshë viktimë e dhunës; është turp të jesh kryesi i saj, kështu që ju lutemi denonconi dhunën.” Në Nëntor-Dhjetor 2012, Mekanizmi zhvilloi një fushatë të ngritjes së vetëdijes kundër dhunës në familje, duke u fokusuar në nxënësit e klasëve të 6-ta e deri në shkollat e mesme, drejtorë të shkollave dhe grupe të grave. Qysh atëherë ata kanë vërejtur ndryshime në shoqërinë e tyre.

“Motivimi dhe dëshira për t'i dhënë fund dhunës ishte gjithëpërfshirëse,” tha Gjejranya. “Raportimi i rasteve të dhunës në familje është rritur, ashtu si edhe vetëdijësimi i viktimave potenciale dhe i njerëzve që punojnë me viktimat potenciale. Kjo temë nuk është më tabu. Njerëzit tani më nuk kanë paragjykitime, dhe ata shpesh kanë ide konkrete se si ta parandalojnë atë.”

“Nuk është turp të jeshë viktimë e dhunës; është turp të jesh autor i saj, kështu që ju lutemi denonconi dhunën.”

Anëtarët e Mekanizmit poashtu kanë avokuar suksesshëm për një dhomë komode intervistash në stacionin policorë të komunës, si dhe një dhomë me lodra për fëmijët kur ata të takohen me prindin që nuk e ka kujdestarinë prindërore.

Në të ardhmen, ata planifikojnë të adresojnë dhunën psikologjike në baza gjinore, veçanërisht në vendin e punës; të avokojnë që më shumë gra t'i bashkohen shërbimit policorë në komunën e Dragashit (e vetmja police udhëton çdo ditë dhe në këtë mënyrë nuk është gjithmonë e pranishme për t'iu përgjigjur rasteve të dhunës); dhe të kontribuojnë në krijimin e databazës së policisë për regjistrimin e rasteve të dhunës në komunë.

Grantet e Fondit të Grave në Dispozicion

Më 15 Shkurt 2013, RrGGK ka lajmëruar hapjen e raundit të dytë të granteve të Fondit të Grave të Kosovës. RrGGK ka ftuar organizatat e veta anëtare që të dorëzojnë aplikacione që do të kontribuonin në realizimin e Objektivave të Strtegjisë të identifikuar nga anëtarët e RrGGK në Planin Strategjik të RrGGK-së për periudhën 2012-2014. Ky raund i granteve financohet nga Austrian Development Agency (ADA) me përkrahje shtesë nga Kvinna till Kvinna (KtK). Afati për dorëzimin e aplikacioneve është 15 Mars 2013. RrGGK pret të shpallë përfituesit e granteve më 15 Prill 2013. Shuma maksimale e mundshme e grantit është 3,000€ dhe RrGGK ka paraparë të ndajë shumën totale 20,000€ në grante gjatë këtij raundi. Kohëzgjatja e projekteve nuk duhet të jetë më e gjatë se gjashtë muaj. Vendimet e financimit do të mirren nga Komisioni Vlerësues i Fondit të Grave të Kosovës, i përzgjedhur nga anëtarët e RrGGK-së. RrGGK do të pranojnë aplikacione në gjuhën Shqipe dhe Serbe. Për më shumë informata klikoni këtu: <http://www.womensnetwork.org/?FaqelD=33>, apo kontaktoni RrGGK-në.

RrGGK Zgjedh Kryetaren e Re të Bordit

RrGGK mbajti mbledhjen e saj të parë të bordit për vitin 2013 më 15 Janar, gjatë së cilës anëtarët e bordit zgjodhën Kryetaren e re të Bordit: Ariana Qosaj Mustafa. Elmaze Gashi u zgjodh Zëvendës Kryetare. Ato do të shërbejnë në një mandat dy vjeçarë.

Anëtarët e Bordit poashtu diskutuan fillimin e pagesave të anëtarësisë për anëtarët e rrjetit me qëllim që të përkrahen iniciativat e ndryshme të RrGGK, aktivitetet e anëtareve dhe shërbimet e ofruara për anëtarët. Bordi vendosi që RrGGK mund të fillojë të mbledhë pagesat e anëtarësisë në shumë prej 20€ në vit. Pas kësaj, Nicole Farnsworth, Menaxhere Programi në RrGGK, prezantoi ndryshimet e bëra në Rregulloren e Punës në linjë me Ligjin e Punës së Kosovës.

Anëtarët e Bordit poashtu diskutuan edhe rregulloren e konfliktit të interesit të RrGGK-së. Ato u pajtuan që në rast se RrGGK krijon partneritet me organizata të udhëhequra nga anëtarët e bordit apo nëse shfaqen fusha të tjera potenciale të konfliktit të interesit (siç përcaktohet nga kjo rregullore), këto çështje duhet të diskutohen dhe aprovohen nga Bordi. Bazuar në këtë vendim, Elmaze Gashi prezantoi projektin në të cilin Alter Habitus, një organizatë që ajo udhëheqë, planifikon të bashkëpunojë me RrGGK-në. Ai përfshinë hulumtimin e titulluar “Ku janë Paratë për të Drejtat Njerëzore të Grave”. Pasi që ky hulumtim do të kontribuojë në Strategjinë e RrGGK-së, Bordi vendosi që RrGGK dhe Alter Habitus mund të vazhdojnë tutje me këtë bashkëpunim.

Në fund, Bordi diskutoi dhe u pajtua për hapjen e një llogarie të re bankare për fondet e qëndrueshme dhe të pakufizuara. Drejtë qëndrueshmërisë së RrGGK-së, llogaria do të mbajë burime financiare që nuk janë të përkrahuara nga donatorët. RrGGK do të ngrisë fonde për këtë llogari përmes pagesave të anëtarësisë, ngjarjeve për ngritjen e fondeve dhe donatorëve individual (p.sh. në Shtetet e Bashkuara të Amerikës përmes East-West Management Institute). Për më shumë informata, kontaktoni info@womensnetwork.org.



Ariana Qosaj Mustafa, Kryetarja e Re e posa zgjedhur e Bordit të RrGGK, merr pjesë në Takimin Vjetorë të Anëtareve të RrGGK.

Anëtarët Takohen për Mbledhjen e Rregullt

Rreth 75 persona morrën pjesë në Mbledhjen e Rregullt të RrGGK-së më 4 shkurt 2013. Pjesëmarrësit përfshinin organizata anëtare të RrGGK, donatorë, anëtarë të bordit dhe mbështetës të tjerë. Mbledhja filloi me një përshëndetje nga Kryetarja e sapo zgjedhur e Bordit të RrGGK, Ariana Qosaj Mustafa. “Faleminderit të gjithëve që më keni dhënë mundësinë të kontribuojë në lëvizjen e grave,” tha ajo. Ajo falënderoi Elmaze Gashin për kontributin e saj si Kryetare e mëparshme e Bordit prej 2011-2012.

Pastaj Aida Dërguti nga Lëvizja Vetëvendosje ndau informatën për Javën e Gruas, të Organizuar nga National Democratic Institute (NDI). Rreth 100 gra që përfaqësonin parti politike, institucione dhe OJQ morrën pjesë. NDI poashtu planifikoi të organizoi Akademinë e Grave për Udhëheqje në vitin 2013; 30 pjesëmarrëse do të përzgjidhen për të marrë pjesë në akademi.

Drejtoresha Ekzekutive e RrGGK Igballe Rogova falënderoi Kvinna till Kvinna (KtK) për besimin dhe mbështetjen për krijimin e Fondit të Grave të Kosovës nga RrGGK dhe për vazhdimin e mbështetjes së tyre në vitin 2013. “Poashtu do të doja të falënderoja anëtarët e RrGGK-së që kanë fituar grante dhe sollën rezultate të suksesshme; dhe anëtarët e RrGGK-së që nuk morrën grante, por që treguan mirëkuptim,” tha ajo. Ajo theksoi se përmes Fondit të Grave të Kosovës RrGGK “jo vetëm ndihmon organizatat financiarisht, por gjithashtu iu ofron trajnim atyre për të ngritur kapacitetet e tyre, bazuar në nevojat që kanë.”

Koordinatorja e Projektit në RrGGK Albertina Binaku ofroi informata të detajuara për raundet e planifikuara të Fondit të Grave të Kosovës për vitin 2013. “Të gjitha anëtarët morrën mbështetje në shkrimin e projekt propozimeve përmes punëtorive dhe kjo mbështetje do të vazhdojë edhe në vitin 2013 në mënyrë që ato të mund të shkruajnë projekte më të mira,” tha ajo.

Koordinatorja për Marrëdhënie me Publikun në RrGGK Nertila Qarri pastaj njoftoi për ndryshimet e bëra në uebfaqen e RrGGK-së, që tani përfshinë një sektor me informata për anëtarët tona dhe Fondin e Grave të Kosovës. Ajo theksoi se RrGGK vazhdon të përdorë rrjetet sociale për të ndarë

informatat (Ju lutem vizitoni [Faqen e Facebook-ut](#), [Grupin e Facebook-ut](#) të RrGGK; dhe [Uebfaqen e re \(www.womensnetwork.org\)](#) për të ndarë informacionet mbi fondin e grave.

Pasi që RrGGK dhe anëtarët e saj kanë krijuar një traditë vjetore të organizimit të një proteste për të shënuar 8 Marsin, Ditën Ndërkombëtare të Gruas, Igballe Rogova hapi diskutimin lidhur me atë se si të shënohet kjo ditë në vitin 2013. Pjesëmarrësit vendosën që tema e avokimit këtë vit do të jetë çasja e grave në sistem shëndetësorë kualitativ, dhe se qytetarët do të ftohen të dhurojnë gjak si një kontribut për kushtet e vështira të sistemit shëndetësorë në Kosovë. Ata vendosën të mbajnë këtë aksion më 8 Mars, në orën 12:00 në sheshin Nëna Terezë në Prishtinë. Informatat e tjera të ndara përfshinin:

- RrGGK do të organizojë një Gala Mbrëmje duke përfshirë edhe aktore dhe këngëtare të famshme ku njerëzit do të ftohen të mbështesin punën e RrGGK. Ghithashtu do të performojë edhe anëtarja e RrGGK-së, Kori i Grave Lira.
- Përmes Gjykatës Regjionale të Grave, një çasje feministe ndaj drejtësisë, gratë aktiviste në Kosovë dhe regjion, vazhdojnë të ngrisin zërat e tyre, duke kërkuar drejtësi për gratë e dhunuara gjatë luftës. Si pjesë e kësaj iniciative regjionale, ishte krijuar një Gjykatë jozyrtare e Grave si një formë tribunali ku gratë kanë hapësirë për të treguar ngjarjet e tyre personale.
- “Qendra Kosovare për Luftimin e Kancerit të Gjirit JETA/VITA” në Prishtinë vazhdon të organizojë aktivitete për të ngritur vetëdijen në mesin e grave dhe institucioneve për këtë çështje.
- Qendra e Gruas Liria në bashkëpunim me Kryetarin e Komunës së Gjilanit dhe Grupin Formal të Grave ka krijuar një mekanizëm koordinues lidhur me dhunën në familje. Grupi ka filluar draftimin e një strategjie për të mbështetur financiarisht strehimoren në Komunën e Gjilanit, në mënyrë që ajo të ketë një fond të qëndrueshëm për të ofruar shërbime për viktimat e dhunës familjare në vitin 2014.
- Shoqata për Femrat me Aftësi të Kufizuara “Femrat për Femra” njoftoi anëtarët se Plani i Veprimit për Barazi Gjimore është aprovuar në Prizren. Ata janë duke krijuar një grup monitorues për të përcjellë implementimin e tij.
- Fondacioni për Edukim dhe Zhvillim implementoi një projekt në Komunën e Novobërdes në vitin 2012, përmes të cilit ata hapën një dyqan ku gratë punojnë dhe shesin produktet e tyre, përfshirë punëdore të ndryshme dhe reçela. Ajo kërkoi që anëtarët që kanë makina për qepje të cilat nuk po i përdorin, t’i dhurojnë ato për këto gra në nevojë.
- “ATO” në Vushtrri implementoi dy projekte të suksesshme në vitin 2012, njëri për edukimin dhe tjetri për shëndetin, përfshirë edhe shëndetin riproduktiv.
- “Hendifer” ofron shërbime për femra. Ata punojnë në baza vullnetare dhe kanë më shumë se 1,600 anëtare, si dhe 45 vullnetare.
- Lidhja e Gjallë e Kosovës tha që puna e tyre në vitin 2012 u koncentrua në edukimin shëndetësor, të cilën do ta vazhdojnë edhe në 2013. Për më shumë, këtë vit ata kanë filluar një iniciativë të re, të quajtur “Loja e Shëndetit”; një grup i grave dhe një i fëmijëve janë krijuar.

RrGGK poashtu informoi anëtarët se ato do të duhet të fillojnë të paguajnë pagesën vjetore të anëtarësimit në shumë prej 20 €. Poashtu, duke filluar nga viti 2013, RrGGK do të paguajë transportin për vetëm një person nga një organizatë dhe vetëm për organizatat në kushte të vështira financiare. Kjo sepse me 100 anëtare, shpenzimet e transportit janë rritur konsiderueshëm dhe është vështirë për RrGGK-në që të vazhdojë t’i mbulojë ato për të gjitha anëtarët e saj. RrGGK kërkon mirëkuptimin e anëtareve në kontributin për rrjetin duke ndihmuar në mbështetjen e këtyre shpenzimeve.

Mbledhja e radhës e anëtareve të RrGGK-së do të mbahet më 8 Prill 2013. Anëtarët mund të dërgojnë informatat për aktivitetet e tyre në info@womensnetwork.org për përfshirje në buletinin mujor të RrGGK, Zëri i Grave Kosovare.



Igballe Rogova, Drejtoreshë Ekzekutive e RrGGK-së ndanë informata me anëtarët e rrjetit.